



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 27 dhjetor 2016, në mbledhjen e XXXV-të
(tridhjetepeshtës), të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekalii, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mrika Thaqi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, propozoi që pas mbledhjes së nesërme të Kuvendit, mbledhje e cila është e fundit në vitin 2016, të mbahet një koktej me këshilltarë të Kuvendit dhe drejtorë të Drejtorive të Komunës, në restorantin “ Ora “.

z. Naim Çunaku, theksoi, jam i mendimit se më mirë do të ishte në vend të koktejit të organizohet një drekë në veçanti nëse pozita e konsideron vit të suksesshëm e për këtë ka elemente të shumta duke u bazuar se në vitin 2016 disa projekte janë realizuar për herë të parë, por edhe nëse opozita është e mendimit se ka kritikuar mjaftë e këtë e konsideron si sukses, andaj një vit i suksesshëm është mirë të përmbillet në mënyrë të suksesshme.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në parim e mbështes propozimin e kryesuesit ngase jam i mendimit se të gjithë ne, aq sa kemi mundur, e kemi dhënë kontributin tonë në punët dhe aktivitetet e Kuvendit, mirëpo për atë se a të organizohet koktej apo drekë për këtë nuk mund të deklarohej ngase nuk jam në dijeni për çështjen buxhetore kur dihet se jemi në fund të vitit, edhe pse cila do variant të jetë nuk ka kosto të madhe.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, unë kam menduar që në këtë rast të organizohet një koktej.

z. Haki Rudari, theksoi, kolegu z. Naim Çunaku këtë organizim e arsyetoi me sukseset e Ekzekutivit, mirëpo unë do të thosha mossukseset e Ekzekutivit dhe jam i mendimit se kjo çështje do duhej të shqyrtohet në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

Gjithashtu nga kolegu Çunaku, kërkoj sqarime se a mund të merr vendime Komiteti për Politikë dhe Financa, ngase për aq sa unë e kam lexuar Rregulloren, ky Komitet nuk mund të merr vendime, këtë e them sepse sipas mënyrës së zhvillimit të diskutimeve duhet të merret vendim. Megjithatë LVV për këtë çështje do të prononcohet në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, për këtë duhet të marrim qëndrim sot ngase për organizime të këtilla restorantet domosdo duhet të bëjnë përgatitje paraprake, andaj është e pamundur që nesër të vendoset dhe pas mbledhjes së Kuvendit të organizohet kokteji. Sa i përket shpenzimeve për organizimin e koktejit, fundja ato shpenzime do t'i paguaj vetë.

Përndryshe, konsideroj se shumica është për organizimin e këtij kokteji.

z. Naim Çunaku, theksoi, z. Haki Rudari në diskutimin e tij e përmendi emrin tim, lidhur me këtë nuk dëshiroj të citoj kompetencat ligjore të Komitetit për Politikë dhe Financa, edhe pse Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale e kam me vete, mirëpo askush nuk propozoi dhe as nuk kërkoji që në mbledhjen e sotme të merret vendim për organizimin e një kokteji, që është çështje pa kurrfarë rëndësie dhe nuk kërkohet fare të merret vendim. Kryesuesi këtë çështje e hapi në formën e konsultimit, pa kërkuar që të merret vendim, pra i gjithë debati u zhvillua për një konsultë përkatësisht se kush është për e kush është kundër.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 5 dhjetor 2016

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozimi i Planit të integritetit

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalii, theksoi, drejtori z. Isuf Latifi, në mënyrë mjaftë të mirë e sqaroi se çfarë përfshinë ky Plan i integritetit e ne shpresojmë dhe besojmë se ky dokument do të gjejë hapësirë dhe do të implementohet në masën më të madhe, andaj Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështet.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, materialin e kemi marrë me kohë, me rastin e miratimit të rendit të ditës e mbështetëm si çështje për shqyrtim, mirëpo diskutimet tona do t'i paraqesim në mbledhje të Kuvendit.

z. Haki Rudari, theksoi, e kam lexuar këtë material mjaftë voluminoz, mirëpo në këtë rast dua të them që për ne është e pranueshme se ky Plan i integritetit është një dokument strategjik dhe operativ që ka dalë nga procesi i vlerësimit të rrezikut në kuadër të Komunës së Podujevës. Në përgjithësi është dokument i mirë por nëse hyjmë në detaje vërejmë se përbëhet nga tre kapituj dhe katërmbëdhjetë fusha vërehen shumë gabime dhe shumë të meta, dhe jam i mendimit se Ekzekutivi i Komunës i ka pa dhe i ka

identifikuar, vërejtje të cilat edhe unë në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV – së, i kam potencuar në mbledhjet e deritashme.

Këtu ka shumë çka për tu thënë por pjesën më të gjatë do ta lë për mbledhje të Kuvendit, e në këtë rast do të veçoj si vijon:

Tek fusha 1 është kapacitetet e dobëta të brendshme të stafit për planifikim të buxhetit, mendoj se është një fushë shumë e rrezikshme që duhet pasë kujdes, ngase është shumë domethënëse. Procesi për arkëtimin e borxheve është i paefektshëm, planet buxhetore nuk janë transparente, abuzim në përdorimin e automjeteve të Komunës, regjistrimi i aseteve nuk ekziston, kapacitetet e dobëta për identifikimin dhe regjistrimin e pronës, edhe kjo është shumë serioze dhe nuk duhet të anashkalohej, pastaj rekrutimi i kandidatëve nuk është efikas. Sistemi i menaxhimit të performancave është i dobët, trajnimet e ofruara nuk janë në përputhje me nevojat e trajnimit.

Funksioni i auditimit është i dobët, jo të gjithë auditorët janë të licencuar në bazë të ligjeve në fuqi, ky është një identifikim mjaftë serioz, Auditorët e brendshëm kanë mungesë të trajnimit profesional, puna e auditimit nuk është e koordinuar dhe planifikuar në tërësi.

z. Isuf Latifi, theksoi, në këtë Plan të integritetit janë identifikuar rreziqet e mundshme dhe nuk paraqet gjendjen aktuale u përmend planifikimi i buxhetit ku nuk ka asnjë mungesë të kapaciteteve për momentin por nuk do të thotë se në tri vitet e ardhshme nuk do të ketë lëvizje të stafit dhe se gjithë here do të jetë mirë. Në këtë dokument janë identifikuar 14 fusha të cilat mund të jenë fusha të rrezikut, pra këto nuk e paraqesin gjendjen e tanishme. Nëse gjatë periudhës përkatëse eventualisht paraqitet ndonjë fushë e rrezikut, është menduar që me këtë Plan të minimizohen apo të evitohen në tërësi.

Po e zëmë e lëshon vendin e punës një specialist i planifikimit dhe mund të paraqitet si rrezik brenda një afati të shkurt, pra sot mund të jetë mirë por në të ardhmen ndonjë fushë mund të paraqet rrezik, në atë rast ne e kemi planin si të trajtohet ai rrezik.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, kam qenë pjesëmarrës në një takim ku është trajtuar ky dokument bazën e të cilit e ka hartuar një ekip i veçantë i licencuar nga UNDP – ja dhe jam i bindur se ky Plan është 90% i njëjtë me komunat tjera, kuptohet përveç specifikave të komunave, pra edhe Komuna e Prishtinës e ka afërsisht të njëjtin plan.

z. Haki Rudari, theksoi, në kapitullin e tretë janë masat e propozuara për integritetin në komunë, kjo nënkupton se ndokund ka pasë lëshime andaj edhe janë propozuar masat për evitim të atyre lëshimeve.

Sa i përket Komunës së Prishtinës, le të flet opozita e atjeshme, kudo që nuk është në rregull unë nuk e përkrahi, por ne këtu duhet të debatojmë për Planin e Komunës tonë.

Pas votimit u konstatua se propozimi i Planit të integritetit, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

4. Propozimi i Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2017 – 2022

- Vendimi për vënie në diskutim publik

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, u pajtua me parafolësin që debati publik me qytetarë të mbahet më 18 janar 2017, por propozoi që koha e fillimit të debatit të jetë në orën 13,00 që është orar më i përshtatshëm e jo në orën 11,00, ngase në shumë debate të organizuara për

fillim në orën 10,00 pjesëmarrësit kanë qenë në numër të vogël për arsye se kanë filluar herët apo në atë kohë kanë qenë të zënë me punë të tjera.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, për ne këshilltarët e Kuvendit nuk duhet të paraqet problem koha e fillimit të debatit, debatin me qytetarë e mban Drejtoria përkatëse dhe kjo duhet të përcaktohet për kohëzgjatjen e debatit, datën dhe kohën e mbajtjes së debatit me qytetarë.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i procedohet për shqyrtim dhe miratim me rekomandim që diskutimi publik të zgjatë prej 29.12.2016 deri më 20.01.2017 dhe data e debatit me qytetarë të caktohet në mbledhje të Kuvendit.

5. Propozimi i Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimt Rinor Lokal në Komunën e Podujevës

- Raporti për zbatimin e diskutimit publik

z. Mrika Thaçi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalju, theksoi, kjo Rregullore është mjaftë e rëndësishme për rininë e Komunës së Podujevës, andaj Grupi i këshilltarëve i LDK – së e përkrahë këtë dokument dhe shpresoj shumë që Drejtoria e Kulturës, rinisë dhe Sportit do të ndaj më shumë mjete buxhetore për t'i ndihmuar të rinjtë të cilët zhvillojnë aktivitete të ndryshme kulturore, artistike dhe sportive.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, Rregulloren ekzistuese të KVRL – së nuk e posedoj, andaj kërkoj nga drejtoresha z. Mrika Thaçi të na e dërgoj në mënyrë elektronike apo nesër në kopje fizike para fillimit të mbledhjes së Kuvendit.

Pajtohem me propozimin që në kuadër të nenit 9.2, ku thuhet “Drejtorja, sipas mundësive dhe nevojës, mbulon edhe shpenzimet tjera për ushtrimin e aktiviteteve të KVRL-së” të ndryshohet si vijon, “Drejtorja, obligohet të mbuloj edhe shpenzimet tjera për ushtrimin e aktiviteteve të KVRL-së, është e natyrshme që buxheti i cili miratohet në Kuvend të Komunës duhet me u siguruar, mirëpo nëse ky Këshill funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, propozoj që buxheti përkatës të parashihet për këtë Drejtori e cila atë buxhet do ta shpenzoj në bazë të aktiviteteve të KVRL – së.

z. Fidan Rekalju, theksoi, dëshiroj të ndërlihem me një pjesë të diskutimit të kolegut z. Rafet Llapashtica, i cili u interesua për formën e funksionimit të KVRL – së dhe shtoi, unë para se të bëhem këshilltar i Kuvendit kam qenë pjesëtar i Organizatave Rinore dhe jam marrë me aktivitete të ndryshme. Forma e funksionimit është në atë mënyrë që Këshilli e bënë Planin vjetor të aktiviteteve duke planifikuar shumat financiare për çdo aktivitet konkret. Lidhur me këtë sigurisht që propozimi i Planit të punës së KVRL – së do të vjen për shqyrtim në Kuvend dhe ne do të përcaktohem për shumën përkatëse e cila sipas mendimit tim nuk do të jetë me e lartë se 10.000 €, shumë e cila nuk është e lartë të destinohet për aktivitetet njëvjeçare të rinisë së Komunës tonë.

z. Haki Rudari, theksoi, i kam përcjellë debatet me qytetarë për dy aktet e vëna në diskutim publik të kësaj Drejtorie, mirëpo në debate numri i pjesëmarrësve është i vogël, besoj se këtë duhet ta pranojmë, andaj sipas mendimit tim nuk mund ta quajmë debat publik nëse numri i pjesëmarrësve nuk është i madh, në rastin konkret i rinisë dhe subjekteve tjera relevante.

Kur është vënë në diskutim publik propozimi i kësaj Rregulloreje e kam përkrahë por kam qenë, jam dhe përherë do të jem kundër politizimit të rinisë llapjane, do të jem kundër asaj që rinia të jetë e nënshtruar nga ndikimet politike. Vërejtjet e mia më në detaje do t'i paraqesë në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

z. Kadri Avdiu, theksoi, deri tash jemi angazhuar shumë pak për rininë, por kjo nuk është e pranishme vetëm në Komunën tonë por në gjithë vendin, e dihet se kur rinia nuk ka një organizim apo mundësi të veprimit mund të bien në veprime devijuese.

Jam i mendimit se kërkesat e arsyeshme të rinisë duhet t'i mbështesim, kuptohet brenda mundësive buxhetore.

Lidhur me atë që tha z. Haku Rudari rreth politizimit të rinisë, sipas mendimit tim janë politizuar edhe njerëzit të cilët punojnë në ara e fusha e të mos flasim për të tjerët. Ne kemi raste që edhe në shkollë fillore në orë mësimi, subjektet politike, nxënësit i përgatitin për çështje politike.

z. Naim Çunaku, theksoi, kur për herë të parë e kemi shqyrtuar një dokument të natyrës së këtillë, ka qenë në mandatin e kaluar, përkatësisht kur e kemi miratuar Planin e punës të Veprimit Lokal Rinor kemi thënë se zhvillimi i aktiviteteve përkatëse e ka një kosto dhe jemi pajtuar që ajo kosto të planifikohet në buxhetin e Komunës e kjo sigurisht në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Tani, për vitin 2017, është miratuar buxheti, meqë veprimtaria e KVRL – së nuk është paraparë në këtë buxhet është e nevojshme që Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në funksion të krijimit të mundësive për zhvillimin e aktiviteteve, të paktën kur shqyrtohet rishikimi i buxhetit, të përgatitet plani i Këshillit në mënyrë që të destinohen mjetet përkatëse për këtë qëllim.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, është mbajtur diskutimi publik lidhur me propozimin e kësaj Rregulloreje dhe vërejtjet e qëndrueshme janë inkorporuar në Raportin për zbatimin e diskutimit publik, andaj propozoj që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim me plotësimet eventuale.

Propozimi i kryesuesit u miratua njëzëri.

6. Propozimi i Statutit të Teatrit të Qytetit “ Avdush Hasani “ në Podujevë **- Raporti për zbatimin e diskutimit publik**

z. Mrika Thaçi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ne nuk i përkasim kësaj fushe, mirëpo në debat publik sigurisht kanë marrë pjesë edhe ekspert të cilët i kanë dhënë propozimet e tyre dhe në këtë drejtim pajtohem se pikat dy dhe tre të paraqitura në Raportin e diskutimit publik janë të qëlluara dhe duhet të inkorporohen në këtë Statut, ngase jam i mendimit se skena e fëmijëve dhe të rriturve është elementare.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim së bashku me propozimet e paraqitura në raportin për zbatimin e diskutimit publik.

7. Propozimi i Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale

- Vendimi për vënie në diskutim publik

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, e kam vërejtur një gabim teknik në vendimin për zbatimin e diskutimit publik ku neni 4 është bartur nga Rregullorja e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, gabim i cili duhet të korrigjohet.

z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e paraqiti fjalën hyrëse.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba komunale është e miratuar, pra është në fuqi, dhe mund të krahasohet me propozimin e kësaj Rregulloreje në mënyrë që të bëhet harmonizimi me ndryshimet e mëvonshme ligjore dhe nënligjore.

z. Haki Rudari, theksoi, meqë është propozim Rregullore që do të vihet në diskutim publik, kërkoj sqarime lidhur me nenin 4.3 ku thuhet, taksa për lëshimin e vërtetimeve nga koordinatori i fshatrave, nuk e kam të qartë se koordinatori i fshatrave a i lëshon vërtetimet në shtëpinë e vet apo ku.

Sa i përket orës për mbajtjen e debatit me qytetarë që u propozua në orën 10,00, nuk jam në dijeni përse Ekzekutivi po insiston që këto debate të mbahen në orë të hershme të ditës, në veçanti në këtë kohë dimri.

z. Avni Fetahu, theksoi, në përgatitjen e propozimit të kësaj Rregulloreje janë të kyçur edhe drejtorët e Drejtorive të tjera, pyetja e parafolësit ka të bëjë me Drejtorinë e Administratës mirëpo sa unë jam në dijeni në Shërbimin civil të Komunës është Koordinator i Komiteteve të fshatrave dhe lagjeve urbane, i cili kryen disa shërbime të caktuara.

Sa i përket orës së mbajtjes së debatit me qytetarë në rekomandim të këtij Komiteti vendos Kuvendi.

z. Naim Çunaku, theksoi, para vënies në diskutim publik të propozimit të kësaj Rregulloreje dëshiroj t'i ngriti disa shqetësime përkatësisht mendime të mia dhe kërkoj sqarime si vijon: në faqe tre parashihen, përpilimi i padisë, përpilimi i ankesave që u parashtrohen gjykatave, përpilimi i ankesave të parashtuara organeve të administratës dhe përpilimi i autorizimit, shtrohet pyetja a i kryen këto shërbime Komuna jonë dhe nëse nuk i kryen duhet të shlyhen.

Te vendosja e objekteve të përkohshme në paluajtshmëri private shuma është 5 €, ndërsa objekteve të përkohshme në paluajtshmëri në pronësi të Komunës shuma është 4.5 €, do të thotë se më e leverdishme është që objekti të vendoset në pronë komunale se në pronë personale.

Te vendosja e shkallëve para objekteve, konsideroj se për këtë duhet të specifikohet gjerësia dhe forma pra të përcaktohen standardet e shkallëve që do të vendosen, përndryshe mund të pengohet qarkullimi në trotuare.

Duke u bazuar me gjendjen shumë problematike sa i përket titullarëve të pronave, ngase titullarë të shumë pronave janë baba babagyshi, vëllai apo ndokush tjetër, problem me të cilin përballemi shumë prej nesh, lidhur me këtë a ka mundësi që të provojmë të krijojë lehtësira për bartjen e pronave në pronarë faktik.

Për mua nuk është e qartë dhe kërkoj sqarime se çka është taksa në transaksionin e pronës së paluajtshme, ku e ka burimin dhe në çka është bazuar, ngase unë nga kureshtja i kam lexuar disa dokumente mirëpo nuk kam gjetur se kjo taksë ka mbështetje

qoftë ligjore apo nënligjore. Shembull për këtë është neni 24.1 ku thuhet, për njësi shtëpi me oborr deri në 100 m² me oborr në sipërfaqe deri 0.05 ha që nënkupton 5 ari, deri në 100 m² lokal afarist, e gjithë kjo duhet paguar 150 € dhe shtrohet pyetja se a është dashtë të ndahen ngase tjetër vlerë ka një shtëpi në qytet, tjetër vlerë ka një ari në qytet e tjetër vlerë kanë në fshat. Mund të marrim edhe një shembull tjetër, nuk dua të keqkuptohem që po i përmendi dy fshatra Tërrenavë e Dyz ku një ari tokë është me vlerë 50 €, ndërsa në qytet është 7.000 apo 8.000 € dhe nëse për një përkthim po e zëmë 10 ari personit të Dyzit do t'i kushtoj mbi 700 € dhe të kalkulohet se me këtë shumë sa ari tokë po i merret atij personi, pra taksa për ta përkthyer do të kushtoj më shumë se shuma e blerjes. Sipas mendimit tim kjo çështje është dashtë të ndahet në zona përkatëse, nëse mbetet por sipas mendimit tim nuk duhet të mbetet për arsye se një pjesë vijuese të propozimit të këtij dokumenti rregullohet çështja e regjistrimit të pronës andaj po del se është taksë e dyfishtë.

Te shfrytëzimi i përkohshëm i pronës komunale, në nenin 25.2 thuhet, dhënia me qira e lokaleve afariste, objekteve dhe hapësirave tjera afariste në pronësi të Komunës bëhet me tender sipas procedurave të prokurimit, unë konsideroj se duhet të hiqet “ sipas procedurave të prokurimit “ ngase prona komunale jepet në shfrytëzim në bazë të ankandit publik në pajtim me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Matja e ndërtesave përsëritet, e kemi dy herë, përveç nenit neni 30.4 figuron edhe në një vend tjetër.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, vërejtjet mund të jepen edhe në formë të shkruar dhe do t'i shqyrtojnë drejtorët në kuadër të kompetencave të Drejtorive përkatëse. Përndryshe propozimi i kësaj Rregulloreje është bazuar edhe në Rregulloret e njëjta të komunave të tjera.

z. Naim Çunaku, theksoi, kam edhe vërejtje të tjera të cilat do t'i deponoj në formë të shkruar.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne nganjëherë edhe në Komitet për Politikë dhe Financa por edhe në Kuvend nuk po kemi durim ta dëgjojmë kolegun të përfundoj diskutimin e tij ashtu siç ndodhi pak më parë me z. Naim Çunakun.

Përshtypje më bëri edhe ajo që tha kryesuesi se propozimi i kësaj Rregulloreje është bazuar edhe në Rregulloret e njëjta të komunave të tjera, unë jam i mendimit se edhe në komunat tjera nuk është gjendja e mirë, pra duhet të bëhemi real se gjendja nuk është e mirë në nivel të vendit, nuk jemi në gjendje të mirë me ligje, me rregullore ngase këto janë kopjuar prej ndonjë shteti tjetër, por këto i kanë punuar edhe amatorët, njerëz që nuk kanë qenë ekspert të fushave përkatëse.

Andaj do të ishte mirë që të bëjmë përpjekje që Komuna e jonë të bëhet më e mirë se komunat tjera.

Edhe unë e kam tokën e pa përkthyer nga xhaxhai, çështje që e ngriti z. Naim Çunaku, dhe për shkak të kostos financiare, si në rastin tim edhe në raste të tjera, kjo çështje mbetet pa u rregulluar. Por më e keqja është se prona të shumta janë në emër të të tjerëve e jo në emër të pronarëve faktik.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, ne duhet të kemi parasysh dy gjera njëra është se është interes i qytetarëve e tjetra krijimi i buxhetit të Komunës, buxhet i cili shfrytëzohet për investime kapitale.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i procedohet për shqyrtim me rekomandim që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, debati me qytetarë të mbahet më 20 janar 2017, ndërsa për orën e fillimit të debatit publik me qytetarë të vendoset në mbledhje të Kuvendit.

8. Propozimi i Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalii, theksoi, sigurisht për këtë çështje do të debatojmë edhe në mbledhjen e nesërme të Kuvendit, por në këtë rast kërkoj që Komisioni për vlerësimin e ofertave për shfrytëzim të përkohshëm të kësaj Qendre të vlerësoj mirë kushtet të cilat i ofrojnë ofertuesit në mënyrë që ky objekt të jetë funksional dhe të krijoj vende pune.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sipas propozimit të vendimit parashihet që në shfrytëzim të përkohshëm jepet vetëm objekti, mirëpo konsideroj se është gabim teknik ngase në shfrytëzim duhet të jepet edhe toka sipas parcelës kadastrale përkatëse.

Ne jemi për atë që ky objekt, kuptohet së bashku me tokën përkatëse, të jepet në shfrytëzim të përkohshëm në kohëzgjatje prej 15 viteve.

Pajtohem me parafolësin që ai objekt t'i jepet në shfrytëzim në mënyrë transparente atij që i plotëson kushtet më së miri.

Grupi i këshilltarëve i PDK – së në Komisionin për vlerësimin e ofertave nuk e ka asnjë anëtar, ka qenë z. Naim Çunaku por ai tash ka kaluar në G +, të kuptohemi jo që nuk i besojmë atij Komisioni por nuk kishim dashtë me u ngritë debate si në rastin e dhënies në shfrytëzim të ish hotelit “ Llapi “ që njihet me emrin “ Beni Dona “.

z. Haki Rudari, theksoi, për mua më shqetësuese është çka pas dhënies në shfrytëzim të kësaj Qendre për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve, Qender e ndërtuar me donacion të Bashkësisë Evropiane, projekt shumë i mirë dhe shumë i qëlluar, por çka pas dhënies në shfrytëzim a mos do të mbyllet, pra për ne më shqetësuese është se çfarë do të ndodh në të ardhmen, ngase ky është një objekt i në rëndësie të madhe.

Shpresoj se Komisioni i ngritur nga Kuvendi për vlerësimin e ofertave do të jetë transparent dhe do ta kryej punën në mënyrë serioze.

z. Naim Çunaku, theksoi, dhënia e pronës komunale në shfrytëzim siç është objekti përkatës me investimet e bëra, sigurisht të gjithë e përshëndesim ngase është në të mirën e zhvillimit të ekonomisë përkatësisht biznesit në Komunën tonë dhe duhet të bëjmë përpjekje që mjetet e investuara qoftë të donacionit qoftë të participimit të Komunës të ruhen dhe të avancohen, andaj për këtë qëllim ai objekt jepet në shfrytëzim.

Në vazhdim shtoi, të mos merret si polemikë po si sqarim, z. Fidan Rekalii, tha se anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ofertave duhet të jenë syçelë dhe të propozojnë ofertuesin që e meriton i cili do ta menaxhoj mirë atë objekt, mirëpo në bazë të dispozitave ligjore në fuqi përzgjedhja e ofertuesit bëhet në bazë të ofertës më të lartë, andaj Komisioni përkatës duhet t'i përmbahet këtij kriteri.

Nuk do të foli për përbërjen e Komisionit për të cilin po diskutojmë, unë jam në përbërje të atij Komisioni dhe është e vërtetë se në atë kohë kam qenë anëtar i PDK – së, mirëpo

PDK – ja nuk ka anëtar as në Komisionin e ankesave, fundja këtu nuk kërkohet përfaqësimi politik në komisionin të cilin e ngrit Kuvendi.

Do ta ngriti një çështje të cilën nuk kisha dëshiruar ta bëjë unë ngase këtë do duhej ta ngriste z. Abaz Llugaliu, kryesues i Komisionit për vlerësimin e ofertave, i cili është në dijeni se Komisioni i ka pasë disa takime dhe e ka kryer punën e vet, mirëpo disa anëtarë të cilët nuk janë shërbyes civil apo ata të cilët nuk ushtrojnë funksione politike në Komunë, edhe pse kanë kërkuar fare nuk janë kompensuar për takimet e zhvilluara, andaj propozoj që të zgjidhet kjo çështje.

z. Abaz Llugaliu, theksoi, pajtohem me vërejtjen e parafolësit dhe shtoi, ne kemi bërë punën tonë por anëtarët të cilët kanë pasë të drejtë në kompensim nuk janë kompensuar, e di se ju kam mbet borxh, andaj do të shikojmë se çfarë mund të bëjmë në të ardhmen. Ndërsa sa i përket vërejtjes së z. Rafet Llapashticës që përveç objektit të jepet edhe paluajtshmëria sipas parcelës përkatëse kadastrale, vërejtja është me vend dhe ky lëshim është bërë ngase propozimi i vendimit është bërë në shpejtësi për ta shqyrtuar në këtë mbledhje, andaj pajtohem që edhe kjo çështje të inkorporohet në këtë vendim, përndryshe tash e kemi edhe kadastrin e ndërtesave që ndërlidhet me parcelën përkatëse. Bazuar në këtë në publikimin e shprehjes së interesit do të figuroj edhe numri i parcelës kadastrale.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, pas vlerësimit të ofertave kontrata lidhet në mes të kryetarit të Komunës dhe përfituesit dhe shpresoj se Zyra ligjore apo hartuesi i kontratës sigurisht se do të parashih edhe një pasues të veçantë që në rast se objekti nuk funksionalizohet apo nuk i përmbush obligimit kontraktuese, të parashihen edhe sanksionet përkatëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, dëshira ime është që në Kuvend të kemi më shumë pika të rendit të ditës të kësaj natyre në mënyrë që aspekti i zhvillimit të avancohet. Pajtohem që ky proces të bëhet në pajtim me dispozita ligjore dhe kush nuk u përmbahet obligimeve ligjore sigurisht do të bartë edhe pasojat.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, nëse Kuvendi merr vendim që të kompensohen anëtarët e Komisioneve, unë sigurisht se do t'i zbatoj, pra nuk kam fuqi t'i ndal. Paguesa do të bëhet në kuadër të Kuvendit të Komunës.

Sipas dispozitave ligjore shërbyesit civil edhe nëse përfshihen në komisione të ngritura nga Kuvendi për punën e tyre nuk paguhen, mirëpo këtu nuk përfshihen këshilltarët e Kuvendit të Komunës.

z. Naim Çunaku, theksoi, në rekomandim të këtij Komitetet, Kuvendi i ka ngritur disa komisione të cilat për punën e tyre janë kompensuar siç është rasti i Komisionit për propozimin e emërtimeve të rrugëve dhe Komisioni për ndarjen e banesave në Lagjen e Dëshmorëve.

Çështjen e kompensimit të anëtarëve të Komisionit për të cilin po debatojmë e ngrita ngase jam në dijeni për pakënaqësinë e disa anëtarëve por edhe timen dhe jam i bindur se nëse nuk do të bëhet kompensimi sigurisht do të dështojnë takimet për shkak të kuorumit.

Sa i përket asaj që tha drejtori z. Isuf Latifi, unë e përmenda se shërbyesit civil nuk kanë të drejtë në kompensim, gjithashtu drejtorët nuk janë shërbyes civil dhe nëse puna bëhet gjatë orarit të punës nuk kanë të drejtë në kompensim, por çka nëse takimi mbahet pas orarit të punës.

Kjo çështje të mbetet propozim i imi, miratoni çfarëdo rekomandimi, mirëpo këtë e bëjë duke e pasë gjithherë parasysh se nëse dëshirojmë një punë të suksesshme duhet bërë kompensimi adekuat ngase vullnetarizmi ka mbet në të kaluarën.

Nëse drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e obligon vetëm vendimi i Kuvendit atëherë të shqyrtohen mundësitë që t'i rekomandohet Kuvendit miratimi i vendimit ashtu siç i ka miratuar vendimet për komisionet e tjera.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, Komisioni për vlerësimin e ofertave për shfrytëzim të paluajtshmërive në pronësi të Komunës është komision i rëndësishëm dhe me përgjegjësi të madhe andaj nuk është e lehtë me qenë anëtar i atij komisioni, andaj duke u bazuar në këtë si përfundim mund t'i rekomandojmë Kuvendit që të miratoj vendimin që anëtarët e këtij komisioni, ata të cilët kanë të drejtë, të kompensohen me mëditje në shumë 50 € për çdo takim, ashtu si komisionet e tjera, por jo të zgjatet në mbledhje të shumta.

Sa i përket përfaqësimit të këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e PDK – së në Komitete dhe Komisione, për këtë çështje kemi biseduar edhe më parë, kam thënë dhe vazhdoj të kem të njëjtin mendim se për këtë duhet të mbajmë një takim me shefat e Grupeve të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend dhe të gjejmë zgjidhjen për këtë çështje, pra unë jam i gatshëm që në çdo kohë të organizoj këtë takim dhe të bëhen lëvizjet e mundshme, pra paraprakisht të bëjmë marrëveshjen dhe pastaj ta procedojmë në Kuvend.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sipas dispozitave ligjore subjektet politike përfaqësohen në komitete dhe komisione të ngritura nga Kuvendi mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve, në këtë kontekst pyetja ime është, a ka të drejtë PDK – ja të ketë përfaqësuesin e vet përkatësisht një anëtar në Komitetin për Komunitete, a duhet PDK – ja të ketë anëtarin e vet në Komisionin e ankesave, përgjigjen për këtë duhet ta jepni ju zotëri kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, komitetet dhe komisionet ngritën me vendim të Kuvendit, jam i vetëdijshëm se janë bërë disa lëvizje nga radhët e subjekteve politike, mirëpo e ceka më parë dhe po e përsëris, kur të dëshironi ulemi me shefat e Grupeve të këshilltarëve e analizojmë këtë çështje dhe i shikojmë mundësitë se çfarë mund të bëjmë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, zotëri kryesues nuk e kam pasë ndërmend të them asnjëherë por po më detyroni, nuk them që të largohen nga Komiteti për Politikë dhe Financa as z. Kadri Avdiu e as z. Naim Çunaku, ngase këta të dytë i kemi propozuar ne vet, as nuk them që nga Komiteti për Komunitete të largohet z. Xhevdet Beselica, mirëpo ju në cilësinë e kryesuesit të Kuvendit duke u bazuar në numrin e këshilltarëve të subjekteve politike në Kuvend duhet të siguronit përfaqësimin proporcional.

Jam i bindur se subjekti politik LDK, sikur të ishte forca e parë opozitare, absolutisht nuk do të kishte lejuar të vazhdohet asnjë hapë përpara pa u zgjidhë kjo çështje.

Unë jam i mendimit se çdo pozitë i ka përgjegjësitë e veta, në rastin konkret kryesuesi i Kuvendit, dhe nëse nuk ushtrohen këto përgjegjësi ne do të ndërmarrim veprime të tjera në pajtim me dispozita ligjore.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, kryesuesi i Kuvendit nuk e ka rrolin që të merr vendime, vendimet i merr Kuvendi.

Sa i përket përbërjes së komiteteve dhe komisioneve të ngritura në fillim të mandatit, ti nuk ke qenë në atë rast, mirëpo i pranishëm ka qenë përfaqësuesi i subjektit të juaj politik i cili është në dijeni se harmonizimin e propozimeve përkatëse e kemi bërë pas punës

disaditore, andaj kjo çështje pa harmonizim paraprak nuk mund të vihet për shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit u konstatua se propozimi i Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim me plotësim që përveç objektit, të figuroj edhe parcela e paluajtshmërisë përkatëse.

Njëherit rekomandohet që anëtarët e Komisionit vlerësues për propozimin e dhënies së pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cilët nuk janë shërbyes civil, për punët e kryera të kompensohen me mëditje në shumë prej 50 €.

9. Propozimi i vendimit për miratimin e Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2017

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

Propozimi i Vendimit për miratimin e Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2017, u miratua njëzëri me korigjimin e propozuar nga z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, që në muajin korrik “ Informata për përfundimin e vitit shkollor 2016/2017 “ të ndryshohet “ Informata për përfundimin e vitit mësimor 2016/2017 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017 “, ndërsa Informata e për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2017/2018 e paraparë për muajin shtator, të hiqet nga Plani i punës.

Mbledhja përfundoi në orën 14.50’.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-93204
Podujevë,
27 dhjetor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**